

## E DREJTA E PRONËS SË INSTITUCIONEVE FETARE NË JURISPRUDENCËN KUSHTETUESE SHQIPTARE

### Vështrim historik mbi pronën e institucioneve fetare në Shqipëri deri në ditët e sotme

#### *Pronësia përgjatë sistemit komunist*

Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë na jep një kuptim më të gjerë dhe konkret të pronës. Konkretisht, në nenin 149 të tij përcaktohet: *“Pronësia është e drejta për të disponuar dhe gëzuar lirisht sendet brenda kufijve të përcaktuar në ligj”*<sup>(1)</sup>.

Edhe pse kjo e drejtë garantohet si nga kushtetuta dhe kodi civil, nuk do të thotë se ajo është absolute dhe ka gjetur zbatim të drejtpërdrejtë apo dhe tërthorazi. Nga njëra anë shteti kujdeset për garantimin e saj, por nga ana tjetër kontrollon ushtrimin e kësaj të drejte gjithmonë në bazë të ligjeve në fuqi, me qëllim shmangien e abuzimeve të individëve. Nuk duhet harruar procesi i shtetëzimit dhe i konfiskimit të pronave të komuniteteve fetare në Shqipëri pas vitit 1967 dhe censura e besimit fetar.

Prona e klerit fetar, ka njohur koncepte dhe trajtime të ndryshme në periudha të ndryshme historike të vendit tonë. Për nga rëndësia do ta fillonim analizën me periudhën më të gjatë, atë të regjimit politik komunist, për vetë trajtimin specifik që i është bërë të drejtës së pronës gjatë kësaj periudhe si dhe eliminimit faktik të ekonomisë së lirë. Në vitin 1944 Shqipëria hyri në rrugën e zhvillimeve dhe transformimeve rrënjësore me karakter komunist. *“Në etapën e parë të kalimit nga kapitalizmi në socializëm krahas pronës socialiste ekzistonte dhe prona private”*<sup>(2)</sup>. Kjo gjë faktej edhe në

<sup>1</sup> Ligji nr. 7850, datë 29.7.1994, i ndryshuar, Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë.

<sup>2</sup> Dhimo. Dh, “ E drejta kushtetuese e Republikës së Shqipërisë”, Tiranë, f. 117.

nenin 11, paragrafi 1 i kushtetutës së vitit 1946, e cila konsiderohet si akti i parë bazë që rregullonte marrëdhëniet e pronësisë. Në të shpallëshin parimet e reja të rregullimit të tyre, ku shprehimisht thuhej:

*“Sistemi ekonomik i Republikës Popullore të Shqipërisë bazohej në: pasurinë e përbashkët të popullit; pasurinë e organizatave kooperativiste popullore dhe në pasurinë e personave fizik”<sup>(3)</sup>.*

Ajo çfarë është e qartë në këtë trajtim, është fakti se akoma nuk e kemi të evidentuar haptazi përjashtimin nga qarkullimi civil të pronës private mbi pasuritë e institucioneve fetare, por kemi një bashkëkzistencë të saj me pronën publike, ndonëse vetëm formalisht. Ndërsa në paragrafin 2 të po këtij neni cilësohej:

*“pronësia private mund të kufizohet e shpronësohet kur e lyp interesi i përgjithshëm në bazë të një ligji”<sup>(4)</sup>.*

“De-juro” pronësia cilësohej si një nga të drejtat e individit, por “de-facto” gëzonte një mbrojtje të dobët dhe prirej për t’u kufizuar nga ana e organeve shtetërore. Një gjë e tillë ligjërohet në një tjetër dispozitë. Pikërisht neni 12, përveç të tjerash shprehet:

*“...toka u përket atyre që e punojnë dhe me ligj caktohet maksimumi i tokës që mund të jetë tokë private”.*

Në këtë rast është vetë shteti i cili vendos se sa pronësi do të posedojë një person, duke afirmuar në këtë mënyrë ndërhyrjen e tij mbi kufizimin e pronësisë<sup>(5)</sup>. Sa më shumë të shtetëzohej prona, aq më i fuqishëm bëhej ai dhe nga ana tjetër aq më i dobët dukej individi përballë tij.

Përgjatë viteve të diktaturës vërehej bashkëkzistenca e regjimit me tipare kapitalizmi dhe socializmi, ku ky i fundit do të triumfonte në vitin 1976 me miratimin e kushtetutës së re, në të cilën sanksionohej zhdukja e pronës private, konkretisht në nenin

<sup>3</sup> Kushtetuta e Republikës Popullore të Shqipërisë, Tiranë 1946.

<sup>4</sup> Po aty.

<sup>5</sup> E drejta e pronësisë, e drejtë themelore e njeriut - Qendra Shqiptare për të Drejtat e Njeriut, f. 7.

16 të saj<sup>6</sup>). Me këtë kushtetutë u eliminua tërësisht domeni i pronës dhe i të drejtave reale të lidhura me të, e individit u zhvesh nga çdo e drejtë mbi pronën, pasi kështu i nevojitej “interesit të përgjithshëm” politik të vendit, duke cenuar në këtë mënyrë të drejtpërdrejtë ushtrimin e të drejtës së lirë të pronës private të individit.

Sipas kushtetutës pronësia ndahej në “*pronë socialiste e cila përbëhet nga prona shtetërore dhe nga prona kooperativiste në bujqësi*”<sup>7</sup>). Këto dy lloj formash të pronësisë janë të tilla që përjashtojnë çdo mundësi të përqendrimit të pasurisë shoqërore e të klerit në duart e individëve të veçantë dhe si pasojë bëjnë të mundur zhdukjen e shfrytëzimit të individit nga individit<sup>8</sup>). Sipas këtij idealizimi prona i përkiste të gjithëve, por askush nuk kishte të drejtë ta gëzonte atë individualisht.

Modeli shqiptar karakterizohej nga eliminimi i të gjitha formave të pronës private nëpërmjet shtetëzimit të plotë të industrisë, tregtisë në shumicë dhe pakicë, dhe të kolektivizimit ekstrem të bujqësisë nga mbështetja e plotë në planifikim të centralizuar, sipas parimit të mbështetjes tërësisht në forcat e veta<sup>9</sup>). Prandaj, kur flasim për aspektin ekonomik themi se transformimi ka hasur probleme, vështirësi, pasoja negative dhe një periudhë kohore të konsiderueshme, kohë, e cila u nevojiti për decentralizimin dhe kthimin e saj në një ekonomi të lirë të tregut.

### *Pronësia pas vitit 1990*

Përmbysja e sistemeve politike, ekonomike dhe shoqërore, që ndodhi në Evropën Qendrore dhe Juglindore përfshiu gjithashtu në mënyrë të pashmangshme edhe shtetin tonë në vitet ‘90. Bilanci i humbjes pasurore dhe pronësore ishte me kosto të lartë. Rreth 1 milion metra katrorë e bashkësisë islame ishte keqpërdorur dhe dhunuar, e pjesa tjetër ndarë dhe degraduar. Vendi ynë u ndikua nga ndryshimet politike që ndodhën në vendet e tjera ish-komuniste, duke pësuar ndryshime rrënjësore në qeverisje dhe gjithashtu për sa i përket konceptit dhe ushtrimit të pronësisë.

<sup>6</sup> Erarbër.M, “Mbrojtja e pronësisë dhe jurisprudencë”, f. 45.

<sup>7</sup> Grup autorësh – E drejta kushtetuese f. 116.

<sup>8</sup> Dhimo. Dh, “E drejta kushtetuese e Republikës së Shqipërisë”, f. 19.

<sup>9</sup> Prof. Dr. Anastas Angjeli, “Tranzicioni dhe liria ekonomike në Shqipëri”, f. 30.

Rruga e vështirë e Shqipërisë nga diktatura në demokraci, nga ekonomia e centralizuar në ekonominë e lirë të tregut, është historia e një vendi, që tranzicionin e filloi nga një izolim ekstrem, nga një varfëri e madhe dhe pa asnjë lloj infrastrukture<sup>(10)</sup>. Për të transformuar sistemin ekonomik ekzistues në një ekonomi të tregut të lirë janë miratuar një sërë ligjesh dhe VKM-sh, të cilat në tërësinë e tyre formuan atë që do të konsiderohet si jurisprudencë kushtetuese në kuadër të trajtimit të së drejtës së pronësisë dhe që shërbeu për vite me radhë për përmirësimin dhe mbrojtjen e kësaj të drejte. Ndër aktet më të rëndësishme mund të përmendim: Ligjin nr. 7501, datë 19.07.91 “Për Tokën”; Ligjin nr. 7652, datë 12.02.93 “Privatizimi i shtëpive”; Ligjin nr.7698, datë 15.04.93 “Kthimi i pronës”; VKM nr. 190, datë 16.04.90 “Krijimi i Agjencisë Kombëtare të Privatizimit”; VKM nr.19, datë 16.04.93 “Rifillimi i procesit të privatizimit”; VKM nr.386, datë 26.07.93 “Dhënia me qera e pronës shtetërore” etj.

Pragu i viteve '90 shënon nisjen e reformave që lidhen me liberalizimin e tregtisë së lirë dhe sipërmarrjeve të lira ekonomike, ndër të cilat evidentoheshin të drejtat e lidhura me pronësinë. Hapi fillestar ishte miratimi i *Ligjit Kushtetues* më 29.04.1991, i cili sanksiononte të drejtën e pronës, në ndryshim nga kushtetuta e 28 dhjetorit 1976, e cila e eliminonte atë. “*Bujqësia ishte sektori i parë për t’u privatizuar, kryesisht përmes çmontimit të kooperativave bujqësore*”<sup>(11)</sup>. Ndërkohë, me ligjin për tokën nr. 7501, datë. 19.7.1991, u hap rruga për privatizimin e mëtejshëm të tokave bujqësore, ish – kooperativa. Kështu, neni 2 i këtij ligji shprehet: “*Shteti u jep tokë personave fizikë a juridikë. Këta gëzojnë të drejtën e pronësisë dhe të gjithë të drejtat që përmbahen në këtë ligj*”.<sup>(12)</sup> Sipas këtij neni të gjithë kanë të drejtë të kenë një pronë, në ndryshim nga e kaluara. Në pjesën më të madhe të dispozitave të këtij ligji përcaktohej:

*“... 1. Toka do ndahej, shpërndahej në mënyrë proporcionale në çdo familje në bazë të numrit të anëtarëve të familjes, duke filluar që nga gushti 1991. 2. Toka do të vlerësohet në bazë*

<sup>10</sup> Eduart Kaca, Shqipëria nga diktatura në demokraci (Teori dhe praktikë), f. 9.

<sup>11</sup> Daniel Vaughan-Whitehead-Albania in crisis: the predictable fall of the shining star, f. 152.

<sup>12</sup> Ligji për tokën, Nr.7501, dt.19.07.1991.

të sistemit të vaditjes, pjerrësisë dhe cilësisë me qëllim që të bëhet një shpërndarje e drejtë..."<sup>(13)</sup>. Në bazë të këtij ligji toka do të ishte dhuratë e familjeve vendase, ish – anëtarë të kooperativave dhe fermave bujqësore”.

Ndërsa ligji nr. 7512, datë.10.08.1991 shprehet në nenin 1 të tij:

*“Në Republikën e Shqipërisë sanksionohen dhe mbrohen prona private, nisma e lirë, veprimtaritë private të pavarura, afarizmi, investimet e huaja, e drejta për të marrë e për të dhënë kredi, e drejta për të punësuar e për t’u punësuar, privatizimi i pronës shtetërore dhe i gjithë procesi i kalimit të ekonomisë së Republikës të Shqipërisë nga një ekonomi e planifikuar dhe e kontrolluar nga shteti, në një ekonomi të tregut të lirë”. Në këtë prizëm, “Shqipëria filloi procesin e saj të privatizimit në masë të vogël”<sup>(14)</sup> pikërisht me këtë ligj. Kështu, filloi privatizimi i ndërmarrjeve shtetërore dhe shërbimeve sociale<sup>(15)</sup>, të cilat u trajtuan si objekte të privatizimit.*

Gjithashtu filloi edhe privatizimi i shtëpive të banimit nëpërmjet miratimit të ligjit nr. 7698, datë 15.04.1993 “Për rikthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve” dhe ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore”. Edhe pse ligjet tashmë ishin miratuar, u hasën vështirësi në vënien në praktikë të tyre, gjë e cila u shoqërua me lindjen e një sërë konfliktesh. Krahas procesit të privatizimit të pronës shtetërore, shteti i ri demokratik u vu përballë një realiteti me probleme të mprehta politike, ekonomike e sociale, rrjedhojë e padrejtësive të bëra nga shteti totalitar komunist për rreth 50 vjet rresht ndaj pronarëve.

Gjithashtu në kuadër të procesit të privatizimit dhe në bazë të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin e kompensimin e pronave ish-pronarëve” neni 22, u vendos krijimi i Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave. Pas njohjes së të drejtës së pronësisë, ish-pronarët kishin të drejtën e kthimit të saj në natyrë

<sup>13</sup> Daniel Vaughan-Whitehead-Albania in crisis: the predictable fall of the shining star, f. 153.

<sup>14</sup> Daniel Vaughan-Whitehead-Albania in crisis: the predictable fall of the shining star, f. 154.

<sup>15</sup> Prof. Dr. Anastas Angjeli-Tranzicioni dhe liria ekonomike në Shqipëri, f. 124.

nëse plotësoheshin kushtet e mëposhtme: a) toka ishte në formën e kullotës, livadhit, tokës pyjore apo tokës bujqësore; b) të ishte e pa trajtuar nga ligji nr. 7501, datë 19.07.1991; c) të ishte në pronësi të shtetit<sup>(16)</sup>.

### *Regjimi aktual i pronës*

Me pronësi të autoriteteve fetare në pikëpamjen juridike do të kuptojmë marrëdhënien e zotërimit të sendeve, së cilës i referohen një sërë të drejtash reale. Në nenin 11 të Kushtetutës së Shqipërisë<sup>(17)</sup> sanksionohen parimet kryesore të një shteti, i cili bazën e ka në iniciativën e lirë të ekonomisë së tregut<sup>(18)</sup>. Mbrojtja e të drejtave dhe e lirive themelore të individit ka prioritet në shtetin demokratik. Shteti i së drejtës, kuadri ligjor në tërësi dhe institucionet që ngrihen mbi këtë bazë kanë si synim dhe objektiv kryesor, pikërisht, garantimin dhe mbrojtjen sa më të mirë dhe në mënyrë sa më efektive të të drejtave dhe lirive themelore të individit. Natyra e të drejtës së pronësisë është tepër komplekse, pasi në të përfshihen si prona private ashtu dhe ajo publike, të cilat mbrohen njëllë me ligj<sup>(19)</sup>. Grupimi në këto dy kategori të mëdha evidenton edhe karakteristikat e secilës prej tyre, si dhe ndryshimet që ekzistojnë mes këtyre dy regjimeve. Tri janë tiparet bazë të pronës publike:

1. Është e patjetërsueshme
2. E paparashkrueshme dhe
3. Nuk është objekt ekzekutimi.

Ndërsa sendet objekt të pronës publike përcaktohen nga tri kritere:

1. Shpallja si të tilla me aktet normative.
2. Nga natyra e tyre.
3. Nga përdorimi i tyre.

---

<sup>16</sup> Ligji nr 7698, datë 15.04.1993.

<sup>17</sup> Në kuptim të këtij punimi dhe të faktit që për sa i përket kufizimit të lirive dhe të drejtave themelore kushtetuta barazohet me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

<sup>18</sup> Neni 11 i ligjit nr. 8417, datë 21.10.1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (i ndryshuar).

<sup>19</sup> Po aty.

Të gjitha sendet që përmbushin këto kushte dhe përfshihen në këtë kategori, përbëjnë objektin e pronës publike që i përkasin shtetit dhe njërive të qeverisjes vendore, pra përbëjnë kështu përmbajtjen e pronës publike dhe arsyen e ekzistencës së saj.

### *Kufizimi i të drejtës së pronësisë për disa kategori*

Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë përcaktohet: “E drejta e pronës private është e garantuar”<sup>(20)</sup>. Ky nen parashikon garancinë që sigurohet nga shteti në drejtim të gëzimit të pronës private në 2 aspekte: në radhë të parë kjo ju lejon individëve privatë të jenë pronarë mbi sendet, dhe në radhë të dytë garanton çdo pronar nga ndërhyrjet arbitrare të shtetit. Pronësi e garantuar nuk do të thotë e paprekshme, pasi shteti mund të ndërhyjë në të drejtat e pronësisë së një individi, por vetëm në rastet e përcaktuara në ligj.<sup>(21)</sup>

Pronësia private në shtetet e sotme demokratike ka një rol mjaft të rëndësishëm, si në aspektin privat, ashtu edhe në atë shoqëror. Funkcioni *privat* që ka e drejta e pronës sjell ndikimin e vet në gëzimin normal të lirive dhe të të drejtave të individit. Kuptimi historik dhe ai sotëm i garancisë së pronës është kuptimi i një të drejte themelore që lidhet pazgjidhshmërisht me lirinë individuale për të disponuar lirisht sendin. Prona ka njëkohësisht edhe karakterin e dallueshëm *shoqëror*, sepse përdorimi i saj duhet t'i shërbejë mirëqenies publike. Për sa kohë funksioni i pronës është një mjet për ruajtjen e lirisë vetjake, prona gëzon një mbrojtje të veçantë. Nga ana tjetër, ligjvënësi mund të vendosë kufizime ndaj pronës, sa më i madh të jetë funksioni social i saj. Kufizimet e së drejtës së pronësisë paraqiten në dy forma: *së pari si shpronësime* ose kufizime që barazohen me shpronësimin dhe *së dyti si kufizime* në ushtrimin e të drejtës së pronësisë<sup>(22)</sup>. Në kategorinë e parë duhet theksuar se do të shpronësohet pasuria, ndërsa në kategorinë e dytë kemi vetëm kufizim ndaj të drejtës së pronësisë, po jo zhveshjen nga të drejtat absolute që

<sup>20</sup> Neni 41/1, Kushtetuta, Tiranë, 1998, f 22.

<sup>21</sup> Në këtë rast bëhet fjalë për ligjin në kuptimin formal, pra ligji i dalë nga Kuvendi dhe jo çdo akt me përmbajtje normative.

<sup>22</sup> Prof.L.Omari/Prof.Dr.A.Anastasi: E drejta kushtetuese, f. 153.

burojnë prej saj. Ligji nr.22.12.1999 “Për shpronësimin e pasurisë private” përcakton në nenin 17/1 kushtet e shpronësimit, të cilat realizohen:

- Vetëm për interes publik, edhe në qoftë se kërkesa bëhet nga një subjekt privat;
- Interesi publik të mbizotërojë kundrejt interesave privatë të pronave të tyre;
- Privimi nga kjo e drejtë duhet të shoqërohet nga një shpërblim i drejtë;
- Kufizimi i kësaj të drejte nuk duhet të prekë thelbin e saj”<sup>(23)</sup>.

### *Shpërblimi i drejtë*

Një nga kushtet e procesit të shpronësimit është se ky proces duhet detyrimisht të shoqërohet me një shpërblim të drejtë. Çështja e detyrimit për dëmshpërblimin në vetvete përcaktohet nga rrethanat e rastit konkret.<sup>(24)</sup> Organeve kompetente në lidhje me këtë çështje iu është lënë hapësirë veprimi në varësi të situatave konkrete. Nga praktika është vënë re se shpeshherë personat e shpronësuar janë të pakënaqur me masën e shpërblimit të akorduar me VKM. Në vendimin nr. 30/2005, Gjykata Kushtetuese është shprehur:

*”Shpërblim i drejtë jo domosdoshmërisht do të thotë i plotë. Kriteri për shpërblimin ose kompensimin në dobi të ish-pronarit nuk mund të jetë i plotë, por i drejtë”.*<sup>(25)</sup>

Ky rregullim kushtetues i detyrohet jo vetëm funksionit të dyfishtë privat dhe shoqëror që mbart në vetvete e drejta e pronës, por edhe rrethanave historike, politike, ekonomike, shoqërore e juridike, të cilat kanë ndikuar në situatën e krijuar, dhe si të tilla, nuk mund të mos i kishte parasysh ligjvënësi.

Këshilli i Ministrave është organi që ekzekuton vendimet e Gjykatës Kushtetuese dhe në të njëjtën kohë është organi që paraqet projektbuxhetin për vitin e ardhshëm financiar të vendit

<sup>23</sup> Prof.L.Omari/Prof.Dr.A.Anastasi: E drejta kushtetuese, f. 154.

<sup>24</sup> Prof.L.Omari/Prof.Dr.A.Anastasi: E drejta kushtetuese, f. 154.

<sup>25</sup> Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr 30/.2005.

dhe rrjedhimisht është organi kompetent për të përcaktuar anën financiare të procesit të shpronësimit apo kompensimit financiar<sup>(26)</sup>.

### **Konkluzione**

Në këtë punim analizuam çështjen e së drejtës së komuniteteve fetare mbi pronësinë ndër vite në Shqipëri dhe kryesisht duke e vënë theksin te jurisprudenca kushtetuese shqiptare dhe ajo e Strasburgut. Sistemi shqiptar i drejtësisë ka bërë hapa të rëndësishëm për sa i përket njohjes dhe garantimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe të drejtave të klerit, duke përfshirë këtu edhe të drejtën e pronës, gjë e cila është evidentuar dhe tek progres-raporti i komisionerëve të Bashkimit Evropian. Gjithashtu janë evidentuar ndryshimet ndërmjet trajtimeve ligjore të ndryshme që i janë bërë pronës në periudha të ndryshme kohore, në varësi të sistemeve politike. Gjatë viteve të sistemit socialist prona në Shqipëri klasifikohej vetëm në shtetërore, duke nxjerrë nga qarkullimi pronën private dhe atë të juridiksionit klerikal, ndërkohë pas viteve 1990 nëpërmjet një sërë ligjesh u ndërmor një reformë e cila synonte kthimin e të drejtave mbi pronësinë ish-pronarëve të shpronësuar gjatë kësaj periudhe, duke përfshirë kthimin fizik dhe kompensimin financiar të pronave për bashkësitë fetare.

Por vitet '90 do të linin gjurmë në këtë çështje në Shqipëri, duke filluar që nga konfliktet e brendshme dhe deri te stepja e investitorëve të huaj për të investuar në Shqipëri. Kjo erdhi si pasojë e moszgjidhjes së problemit të pronës, pasi ata ishin të pasigurt për të investuar kapitalin e tyre. Përveç ligjeve të miratuara, rol thelbësor ka luajtur edhe Gjykata Kushtetuese, e cila në fillimet e saj duhet theksuar se ka punuar në një gjendje tejte të rënduar si pasojë e sistemit të sapo "adaptuar" demokrat.

Procesi i privatizimit në Shqipëri ka qenë një proces deri diku i ndërlikuar, i cili ka hasur probleme gjatë zbatimit praktik të tij, por kurrësi nuk mohohen vlerat që ky proces i dha një prej të

---

<sup>26</sup> Ky i fundit është mjeti më i përdorur, sepse ish-pronarët nuk pranojnë të kompensohen në natyrë, por vetëm në para.

drejtave themelore të njeriut, siç është ajo e pronës. Privatizimi u realizua nëpërmjet një sërë ligjesh, të cilat në periodha të ndryshme pësuan edhe ndryshimet përkatëse, në varësi të situatave konkrete. Reformat ekonomike të ndërmarra në Shqipëri në fillimet e instalimit të një sistemi demokratik, pas vetes kishin edhe instalimin e një ekonomie të lirë të tregut.

### *Bibliografia:*

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Shtypshkronja "Expres", Tiranë 2008;
- Kodi Civil 1994;
- Angjeli. A, " "Tranzicioni & liria ekonomike në Shqipëri", Tiranë 2004;
- Dhima. DH, "E drejtë kushtetuese e Republikës Popullore Shqiptare", Shtypshkronja "Mihal Duri", Tiranë 1963;
- Grup autorësh, "E drejtë kushtetuese", Shtypshkronja e Dispensave, 1981;
- Hana. L & Telo. I, "Tranzicioni në Shqipëri, Arritje dhe Sfidë", Mësonjtorja, Tiranë 2005;
- Koca. E, "Shqipëria nga diktatura në demokraci" (teori&praktikë), Tiranë 2004;
- L.Omari & A.Anastasi, "E drejtë kushtetuese", Shtëpia botuese "ABC", Tiranë 2008;
- Madhi. E, "Mbrotjtja e pronësisë dhe jurisprudenca", Shtëpia botuese "Triptik", Tiranë 2008;
- Ligji nr. 7501, dt.:12.07.1991 "Për Tokën";
- Ligji nr. 7512, dt. 10.08.1991 "Për Sanksionimin dhe mbrotjtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarisë private të pavarura dhe privatizimet.
- Ligji nr.7698, dt. 15.04.1993 "Për kthimin dhe kompesimin e pronave";
- Ligji nr. 8561, dt.21.12.1999 "Për shpenzimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë së pronës private";

- Ligji nr. 9583, dt. 17.07.2006 “Për disa ndryshime në Ligjin për kthimin dhe kompesimin e pronave”;
- Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 11, datë 27.08.1993.
- Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 9, datë 31.07.1995;
- Marrëveshjet ndërfaqetare Qeveri & Komunitetet fetare, shkurt 2007;
- Prof. Dr. Sabri Kadriu, Financat Publike, 2016.